

PROGRAME INTERNSHIP-I NË UNION BANK

Union Bank operon prej më shumë se 16 vitesh në tregun shqiptar e pozicionuar si një bankë e shëndetshme dhe e qëndrueshme ku nëpërmjet një rrjeti të gjerë prej 32 degësh dhe 60 ATM në qytetet më kryesore të Shqipërisë, u shërben me profesionalizëm mbi 185,000 klientëve. Prej fillimit të aktivitetit në vitin 2006, banka ka shënuar një rritje domethënëse në tregun bankar duke arritur mbi 650 milion Euro asete.

Union Bank ofron një kulturë pune ku vlerësohet diversiteti, ku çdo pjesëtar i skuadrës është shumë i rëndësishëm për suksesin e biznesit prandaj impenjohemi maksimalisht të krijojmë një ambient motivues, gjithëpërfshirës dhe me shanse të barabarta zhvillimi. Gjithashtu ne investojmë në mënyrë të vazhdueshme në trajnimin dhe zhvillimin e punonjësve për të ofruar një eksperiencë të shkëlqyer bankare për klientët tanë.

Union Bank dëshiron të ofrojë mundësinë për zhvillimin e programeve të praktikës në disa departamente/degë, **për studentët e të gjitha degëve të ciklit Bachelor dhe Master të University of New York Tirana**, për një periudhë 3 mujore.

Praktika mund të kryhet në Degët e Union Bank dhe/ose në Departamente të ndryshme pranë Zyrave Qendrore. Programi do të mundësojë njohjen e funksioneve kryesore si dhe përfshirjen e studentëve në praktikë në disa prej proceseve të thjeshta të degëve/departamenteve ku ata do të angazhohen.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët e interesuar:

1. Të jenë studentë të ciklit Master ose Bachelor (viti 3)
2. Mesatare e studimeve mbi 8

Studentët që janë të interesuar për të ndjekur këto programe, duhet të dërgojnë brënda **datës 15 Janar 2023** në adresën humanresources@unionbank.al, dokumentat e mëposhtëm:

1. Curriculum Vitae
2. Kopje të diplomës dhe listës së notave të ciklit Bachelor/ të ciklit Master (Studentët që nuk kanë përfunduar ciklin Bachelor, mund të dërgojnë vetëm listën aktuale të notave).
3. Kopje e skanuar e ID

Union Bank angazhohet maksimalisht për tju ofruar studentëve mundësinë e njohjes se një sistemi financiar duke i përfshirë në procese apo projekte specifike, nga ku ata mësojnë, zhvillojnë njohuritë e tyre dhe njëkohësisht bëhen pjesë e një skuadre.

Pas përfundimit të programit të praktikës, duke vlerësuar përkushtimin dhe performancën e tyre, studentet pajisen me Vërtetimin e ndjekjes së praktikës dhe Certifikatën përkatëse.

Union Bank është gjithmonë në kërkim të talenteve të reja, ndaj nëse vlerësimet janë pozitive, ekziston mundësia që praktika të përmbyllet me punësim.